



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0349

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim-Kryesuese, Kimete Gashi-Brajshori dhe Vedat Poterqoi-Anëtar të Panelit Shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së OE “Eng Idea SH.P.K.”, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi i projekteve te ndryshme” me nr. të prokurimit: "623-26-2856-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Rahovecit, më 15.06.2026, mori:

Vendim

I. Përfundon procedura e shqyrtimit në këtë çështje administrative, për shkak të pajtimit të arritur mes palëve, Komuna e Rahovecit nga cilësia e autoritetit kontraktues dhe Operatorit Ekonomik “Eng Idea SH.P.K.”, me nr. 2026/0349, e datës 31.05.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi i projekteve te ndryshme” me nr. të prokurimit: "623-26-2856-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Rahovecit.

II. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore sipas paragrafi 4, 5 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar, të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Me 29.04.2026, Komuna e Rahovecit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin për Kontratë (NJK) dhe dosjen e tenderit (DT), për aktivitetin e prokurimit “Hartimi i projekteve te ndryshme” me nr. të prokurimit: "623-26-2856-2-1-1".

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës kontratë publike kornizë-shërbim vlera e parashikuar e kontratës: 350,000.00 €.

Me 19.05.2026, OE “Eng Idea SH.P.K.”, nga cilësia e tij/sajë si palë e pakënaqur me njoftimin e cituar ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila i refuzon si të pabazuar me Vendimin e AK

të datës 20.05.2026.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, me 31.05.2026 OE “Eng Idea SH.P.K.”, ka ushtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit të cituar si më sipër të AK, e cila është evidentuar me numër të protokollit 2026/0349.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 09.06.2026, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim: *“Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues-teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim”*.

Konstatohet paraprakisht se, raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore sikurse kërkohet me nenin 113, paragrafi 3 të LPP dhe i njëjti është pranuar nga të dyja palët, konform nenit 115 të LPP lidhur me nenin 20 të Rregullores së cituar. Në këtë rast evidentohet se të dyja palët (AK dhe OE) janë në dijeni lidhur me shkresat komplete të kësaj lënde sikurse kërkohet në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të Rregullores për Punën e OSHP dhe se të dyja palët kanë deklaruar formalisht

-AK me më 12.06.2026 pajtohet si dhe,

-OE me datën 10.06.2026 se pajtohet me rekomandimin e ekspertit shqyrtues dhe teknik.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli konsideron se procedura e shqyrtimit përfundon në këtë fazë në kuptim të pajtimit (marrëveshjes) së arritur të palëve dhe rrjedhimisht ankesa ka humbur objektin ankimor sikurse kërkohet shprehimisht me dispozitën e nenit 11, të LPP. Me rastin e shqyrtimit të shkresave të kësaj lënde, natyrës dhe qëllimit të sajë, Paneli shqyrtues konsideron se palët mund ti zgjidhin raportet eventualisht kontestuese mes vete në ato raste kur ato në saje të legjislacionit, disponojnë lirisht me të drejtat e tyre.

Pajtimi i arritur mes palëve nuk bije nësh me parimet bazë dhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës dhe nuk e atakon pavarësinë institucionale të AK saj, për të zgjidhur çështjen kontestuese, meqë e lejon natyra e çështjes në rastin konkret, mes tjerash konform nenit 19 paragrafi 4 të Rregullores se Punës së OSHP-së Nr. 01/2020 (e amandamentuar).

Megjithatë, Paneli ju kujton palëve se në kuptim të nenit 19, paragrafi 4, të Rregullores për punën e OSHP parashihet se, cituar: *“Në rast se autoriteti kontraktues dhe parashtruesi i ankesës*

pajtohen me raportin e ekspertit shqyrtues, paneli shqyrtues nxjerrë njoftim që autoriteti kontraktues në afat prej 5 ditësh ta implementoj raportin e ekspertit shqyrtues duke i njoftuar palët në procedurë. Për më tepër informohen palët, që ky vendim ka karakter procedural për palët në procedurë dhe në rrethana të tilla të gjeturat e këtij raporti nuk i janë nënshtruar vlerësimit nga Paneli Shqyrtues. Andaj, paneli shqyrtues nuk është lëshuar fare në vlerësim të pretendimeve ankimore por vetëm nxjerrë vendim për përfundimin e procedurës.

Prandaj bazuar shkurtimisht në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues ne pajtim me nenin 105, 116 dhe 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahimi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**
- **OE - ENG IDEA SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: